



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:203141

Datë: 17.10.2022

Numri i dokumentit: 03535356

P.nr.04/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Dinore Xhemajli, në lëndën penale ndaj të pandehurit: S.M, për shkak të veprës penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365, par. 6, lidhur me par. 1, e lidhur me nenin 31 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.78/2019, datë 08.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 30.09.2022 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Jagodinka Nikolic dhe të pandehurit, më datë 03.10.2022 e shpalli publikisht, ndërsa më datë 17.10.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.M, nga i ati N..., e ëma B..., e vajzërisë M..., i lindur me data e lindjes..., në Zvicër, tani jeton në Mitrovicë, ..., i papunë, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, rom, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Me datën 06.01.2019, rreth orës 05:27, në..., në Mitrovicë, në shtëpinë e vjetër të pronares N. F, në mënyrë që të nxehën kanë grumbulluar druje dhe e kanë ndezur zjarrin në kaminë, ku pastaj nga pakujdesia zjarri ka përfshirë kulmin e shtëpisë si dhe internet kafe i cili gjendet në katin e parë të së njëjtës shtëpi, me ç`rast është shkaktuar dëm material në vlerë prej 6000 (gjashtëmijë) euro.

Me këtë ka kryer veprën penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365, par. 6, lidhur me par. 1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 23, 31, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Në dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 09.09.2019 deri më datë 03.10.2019
3. I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat mbulohen nga mjetet e gjykatës.
4. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.78/2019, datë 08.01.2019, ndaj të pandehurit H.M dhe S.M për shkak të veprës penale: Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365, par. 6, lidhur me par. 1, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Fillimisht, për shkak se i akuzuari H.M, përkundër urdhërarrestit nuk ka mund të sjellet, Gjykata pasi dëgjoj palët, e veçoi procedurën penale ndaj të akuzuarit H.M.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, më datë 30.09.2022 ashtu që i pandehuri në këtë seancë e pranoj fajësinë për këtë veprë penale, duke shprehur kërkim-falje për këtë që ka ndodhur, zjarrin e kemi ndezur për tu nxeh, nuk do ta përsëris më asnjëherë, e lus gjykatën që të merr parasysh rrethanat lehtësuese, dënimi të jetë sa më i lehtë dhe atë për shkak të kushteve ekonomike, ndërsa në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërsi pranë pranimi të fajësisë.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë, ka dhënë mendimin se, konsideroj se janë kushtet për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, pranimi është bërë pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimi të fajësisë, andaj i propozoj Gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërsi pranë akuzë, duke i propozuar gjykatës që ta shpall fajtor të akuzuari dhe dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Deklarata e dëshmitarit K.Sh e dhënë në polici, datë 06.01.2019; Deklarata e dëshmitares N.F e dhënë në polici, datë 06.01.2019; Deklarata e të pandehurit S.M e dhënë në polici, datë 06.01.2019; Raporti i oficerit i datës 06.01.2019; Fotoalbumi me gjithsej 10 fotografi. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo mund të bëjë ankesë sa i përket lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, me nenin 31 të KPRK-së e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, rrethanat personale, marr parasysh kushtet e dobëta ekonomike, faktin se nuk kaën shtëpi të sigurt, jetojnë në kushte të vështira dhe duke lëvizur, pra nuk kanë vendbanim të sigurt.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të akuzuarit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 453, par.4, të KPP-së, ashtu që të akuzuarin e liroi në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale. Kjo duke u bazuar në faktin se i njëjti është e papunë, pa të ardhura, nuk ka vendbanim të sigurt, është kthyer nga jashtë vendi tani dhe jeton në kushte shumë të vështira. Andaj, në këtë rast nëse do të i ngarkoheshin shpenzimet e procedurës do të rrezikohej gjendja materiale e të akuzuarit.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil, në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.04/2019, datë 17.10.2022
2022:203141, 17.10.2022

Procesmbajtësja
Dinore Xhemajli

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.